



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 428/7 Prot.

Tiranë, më 21.07.2016

V E N D I M

Nr. 84, datë 21.07.2016

**Mbi pezullimin e procesit të verifikimit të procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin
"Specialist në Sektorin e Hartografimit", në Drejtorinë e Gjeologjisë,
pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 79 - 86, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin "Specialist në Sektorin e Hartografimit", në Drejtorinë e Gjeologjisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar,

Vërej se:

Me urdhrin nr. 428/1, dt. 20.06.2016, "Për verifikimin e informacionit", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar verifikimin e procedurës së konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë, për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit", në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Ndërkohë, me shkresën nr. 428/6 prot., dt. 07.07.2016, "Kthim Përgjigje", Departamenti i Administratës Publike ka informuar Komisionerin, se pranë këtij institucioni është depozituar një ankesë nga nëpunësi civil ***** në të cilën parashtrohet se ky i fundit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me ***** dhe ***** , të cilët janë anëtarë të Komitetit të Pranimit për ngritje në detyrë, në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar" . Duke vlerësuar që pretendimet e ngritura, krijojnë dyshime të arsyeshme, për mundësinë e ekzistencës së konfliktit të interesit, Departamenti i Administratës Publike, me vendimin nr. 3013, dt. 09.06.2016, ka vendosur të pezullojë zhvillimin e mëtejshëm të procedurës së konkurrimit duke nisur një hetim administrativ për verifikimin e këtij rasti.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 *”Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nenit 66 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *”Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *”Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të pezulloj procesin e verifikimit të filluar me urdhrin nr. 428/1, dt. 20.06.2016, në lidhje me procedurën e konkurrimit për pozicionin *”Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit”*, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, deri në përfundimin e hetimit administrativ, të nisur nga Departamenti i Administratës Publike me aktin nr. 3013, dt.09.06.2016.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe nëpunësi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA